



AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900057/6

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për vënien në dispozicion të një mësuesi ndihmës në shkollën 9 vjeçare "100 vjetori", Kamëz për mbështetjen e nxënësit me inicialet A.M.

ZYRËS ARSIMORE KAMËZ

KAMËZ

Për dijeni:

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës si dhe, ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Shyqyri Muka, banor në lagjen nr.5, në Kamëz.

Ankuesi është babai i fëmijës me aftësi të kufizuar, me inicialet A.M, të cilin e ka regjistruar në shtator 2018, në shkollën 9-vjeçare "100 vjetori" në Kamëz, në ciklin parashkollor. Fëmija vuan nga çrregullime të spektrit të autizmit dhe ankuesi shprehet, se në ditën e parë të regjistrimit të fëmijës, ka informuar stafin drejtues dhe edukator të fëmijës, lidhur me gjendjen shëndetësore të tij.

Ndaj, për dy orët e qëndrimit të tij në klasë (nga ora 8-10), ai ka kërkuar mësues ndihmës.

Meqenëse, ende nuk ka arritur të marrë zgjidhjen e kërkuar, ankuesi shprehet, se më datë 16.10.2018, i është drejtuar me një kërkesë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në vijim, pavarësisht korrespondencave me Zyrën Arsimore Kamëz dhe vetë ministrinë, si dhe mbledhjes së komisionit multidisiplinar në Zyrën Arsimore Kamëz, ende nuk është realizuar vendosja e mësuesit ndihmës për fëmijën e tij.

Në shkresën zyrtare me nr. K5/Sh3-2 prot., datë 17.1.2019, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi informacion, lidhur me problematikën e ngritur nga ana e shtetasit Muka.

Në përgjigje të shkresës zyrtare me nr.60 prot., datë 28.1.2019, Zyra Arsimore Kamëz, na informoi si më poshtë vijon:

-Komisioni Multidisiplinar, i krijuar nga Zyra Arsimore Kamëz, ka përcaktuar numrin e orëve mësimore të nevojshme për fëmijët me aftësi ndryshe, në të gjitha shkollat dhe nivelet e arsimit¹;

-Në shkollën 9-vjeçare “100 vjetori”, Kamëz, në arsimin parashkollor, ku është regjistruar edhe fëmija A.M, komisioni ka vlerësuar që ka nevojë për 0,5 mësues ndihmës, pra 2 orë mësimore në ditë ose thënë ndryshe 10 orë mësimore në javë. Pra, ndodhemi para fakteve, që Komisioni Multidisiplinar pranë Zyrës Arsimore, Kamëz ka vlerësuar nevojën për mbështetjen me mësues ndihmës të nxënësit me inicialet A.M në shkollën 9 vjeçare “100 vjetori”, për dy orë mësimore në ditë.

-Duke pranuar, që është kompetencë e pushtetit vendor vendosja e mësuesit ndihmës në shkollë, si dhe duke qenë mjaft të interesuar për zgjedhjen e problemit të fëmijës A.M, kjo Zyra Arsimore ka parashtruar gjithashtu, edhe nevojën e miratimit të një shtese (numër mësuesish), nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për këtë të fundit, i kanë drejtuar kërkesën përkatëse ministrisë së linjës, dhe janë në pritje të këtij miratimi, të shtesës së numrit të përgjithshëm të mësuesve;

-Megjithëse, Zyra Arsimore e Kamzës shpreh përpjekjet për t’i ofruar shërbimin e nevojshëm fëmijës A.M, në mungesë të mësuesit ndihmës, prindi me të drejtë, është drejtuar në institucionin e Avokatit të Popullit për zgjidhjen përfundimtare të problemit.

¹ Mbështetur në nenet 63, pika 3 dhe 65, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.38, datë 7.10.2014, të MAS “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

Në vijim, me shkresën nr.K5/Sh3-4 prot., më datë 8.2.2109, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Avokati i Popullit ka kërkuar informacion, por ende nuk ka marrë përgjigje.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën për të drejtat e Fëmijës (KDF)² si dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)³. Të dyja konventat parashikojnë që fëmijët me AK duhet të kenë e të gëzojnë të njëjtat të drejta si edhe fëmijët e tjerë, përfshirë këtu të drejtën për arsimim, të drejtën për përfshirje sociale, etj.

Fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të gjitha të drejtat në mënyrë të plotë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë. Në këtë kontekst, fëmija me aftësi të kufizuar gëzon të drejtën për t'u arsimuar sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuara⁴.

Rregullatori bazë i çështjes së edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në BE, është orientimi drejt edukimit përgjatë gjithë jetës dhe detyrimit, që shtetet kanë për të siguruar mundësinë e aksesit në sistemin e arsimimit, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën dhe përpjekjet e bëra nga Zyra Arsimore, për të përmbushur të drejtën e çdo fëmije për t'u arsimuar, siç e parasheh neni 18, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Për këtë qëllim, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

² Neni 28-e drejta për arsim mbi bazën e shanseve të barabarta, “...Shtetet Palë në këtë Konventë duhet:-të bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë...”.

³ Neni 8 i KDPAK kërkon prej të gjitha shkollave të nxisin “në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, duke përfshirë të gjithë fëmijët që nga moshë e hershme”, një qëndrim respektues të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Neni 24-“...afirmon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsimim gjithpërfshirës, në të gjitha nivelet, pa diskriminim dhe mbi bazën e patjes së shanseve të barabarta. Shtetet palë duhet të garantojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara:-nuk lihen jashtë sistemit të përgjithshëm arsimor dhe mund të kenë akses gjithpërfshirës n1% arsimim fillor cilësor dhe falas...”.

⁴ Komenti i Përgjithshëm nr.9 (2006), Komiteti i Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve, “Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, CRC/C/GC/9, 27.2.2007.

REKOMANDOJMË:

-Marrjen e masave për vënien në dispozicion të një mësuesi ndihmës në shkollën 9 vjeçare “100 vjetori”, Kamëz, për të mbështetur nxënësin me inicialet A.M me mësues ndihmës, dy orë në ditë, me qëllim realizimin e masave të parashikuara në Planin Edukativ të Individualizuar të objektivave specifike të nivelit të zhvillimit të fëmijës nga Komisioni Multidisiplinar pranë Zyrës Arsimore.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R I

Nejla PEKA